

**STATUTI & AKT THEMLIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“GJURMA HOSPITALITY” SH.P.K**

Neni 1  
**Emërtimi i shoqerise**

Sot me date 24/01/2024 krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur **“GJURMA HOSPITALITY”** shpk nga ortaku i vetem:  
ALDO MEHMETI shtetas shqiptar i datelindjes 14.05.1988 me Nid .I80514123H me zotesi e pergjegjesi te plote juridike per te vepruar.  
Shoqeria vepron me pergjegjesi te plote juridike dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”. i ndryshuar.

Neni 2

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqërisë **“GJURMA HOSPITALITY”** shpk është VLORE, Lagja “Uji i Ftohte” Rruga “Aleksander Mojsiu” zona kadastrale 8602,ish kompleksi KRISTAL,Vlore . Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

**Kohëzgjatja e veprimtarise**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete subjekt i te drejtes me nje afat te pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut te shoqerise.

Neni 4

**Objekti**

Objekti i shoqërisë do te jete si vijon :

4. 1. Sherbime Bar, Restorant, Piceri, Sushi, Katering
- 4.2. Sherbime komplekse per Pishine, Cadra, Parkim mjetesh.
- 4.3 . Sherbime ne Dyqane Luksi
- 4.4 . Shetitje me varke ne gjirin e Vlores per klientet e vete, barka, motorra deti tj.



- 4.5 Dhenie me qera e ambjenteve, dyqane tj...
- 4.6 Hoteleri -Turzem I te gjitha llojeve
- 4.7 Administrim personeli ,sherbime suporti dhe konsulence per bizneset.
- 4.8 Sherbime
- 4.9 Ambjente pushimi dhe argetimi muzikore tj...

#### NENI 5

##### **Kapitali i regjistruar**

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar ne shoqëri është 100.000 leke (njeqindemije) , numri i kuotave eshte 1( nje) i zoteruar sipas kontributeve nga ortaku I VETEM:  
Aldo Mehmeti, 1 (Nje) kuote ne masen 100% me vlere 100,000 (Njeqindemije) leke  
Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te shoqerise .

#### Neni 6

##### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "GJURMA HOSPITALITY" shpk e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:  
kontributit në kapitalin e shoqërisë;shitblerjes;trashëgimisë;dhurimit  
çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj  
Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.  
Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen ne mbledhjen e asamblese te shoqerise ku te drejten e parablerjes e kane ortaket e shoqerise

#### Neni 7

##### **Asambleja e Pergjithshme e shoqerise**

##### **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e pergjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë përçështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendurnë shkronjat "c" dhe "ç" tëkësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirëpërgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve tëecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin etyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e pergjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikes 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës
- 3.Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të



rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 8

##### **Mbledhja e asamblesë së përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet epërcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një here në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### Neni 9

##### **Mënyra e thirrjes**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi meshkresë ose, nëseparashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

##### **Kërkesa nga ortakët e pakicës**

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur

asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, përtë cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendim marrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

#### Neni 11

##### **Përfaqësimi në asamble**

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga njëperson i tretë.

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 12

##### **Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtëvotë, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 13

##### **Marrja e vendimeve**

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e

përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos meshumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

#### Neni 14

##### **E drejta e votës**

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;

b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

#### Neni 15

##### **Përjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;

b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson

#### Neni 16

##### **Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 17

### Drejtimi dhe administrimit

Shoqëria tregtare **“GJURMA HOSPITALITY”** shpk do të drejtohet nga një administrator që emrohet me vendim të Asamblesë të Shoqërisë. Administratori i shoqërisë për periudhën 5 vjeçare duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit të kësaj shoqërie do të jetë Aldo Mehmeti, shtetas shqiptar i datelindjes 14/05/1988 me kart identiteti i80514123H. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosur nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
- Perfaqësojë shoqërinë tregtare
- Kujdeset për mbajtjen sakte e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë
- Pergatit dhe nënshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto përpara asamblesë së përgjithshme të shoqërisë për miratim,
- Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhenat e detyrueshme siç parashikohen në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit
- Raporton para asamblesë të përgjithshme e shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- Administratori do të shpërblehet sipas përcaktimit të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr 9901 date 14.04.2008.

Neni 18

### Kontrulli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një ekspert kontabel të regjistruar, i cili është përgjegjës përpara shoqërisë për demet që mund të shkaktoje nga moskryerja në rregull e detyrës së tij. Ekspert i pare caktohet Zj Raimonda Alliaj Nr. License eksperti nr.285 viti 2012



Neni 19

**Bilancet dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti, pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakeve te shoqerise.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 Mars te vitit paseardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim asamblese se pergjithshme te shoqerise.

Neni 20

**Shperberja e shoqerise**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe cfardo shkak. Ne rast shkrirje para afatit te shoqerise, Asambleja e pergjithshme e shoqerise vendos mbi menytrat e likujdimit dhe cakton nje ose me shume Likujdator duke i percaktuar dhe detyrat.

Ne rastin e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim " Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Biznesit "

Neni 21

**Dispozitat perfundimtare**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga asambleja e pergjithshme e shoqerise.

Shoqeria "**GJURMA HOSPITALITY**" shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur .

Ky Akt Themelimi e statut nenshkruhet nga ortaku i vetem i shoqerise ne 24/01/2024

**Ortaku i vetem i shoqeris**  
**"GJURMA HOSPITALITY" shpk**

1- Aldo Mehmeti

*Aldo Mehmeti*